



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

-
-
-
-
-

Kronikë

Lezhë/ Me makinë të blinduar dhe pistoletë, 41-vjeçari nuk i bindet Policisë, kapet pas ndjekjes! I vëllai në kërkim për vrasjen e çiftit Mujeci (VIDEO)

Arben Mhillaj u arrestua pas disa minutash ndjekje, pasi nuk iu bind urdhrit të Policisë për të ndaluar. Në makinën e blinduar iu gjet një pistoletë me fishek në fole, ndërsa vëllai i tij, Florin Mhillaj, është në kërkim për vrasjen e çiftit Kreshnik dhe Gentjana Mujeci.

Lezhë/ Me makinë të blinduar dhe pistoletë me fishek në fole, 41-vjeç

Report TV



Watch on

Redaksia
27 Gusht, 14:08 | Përditësimi: 27 Gusht, 14:30

Share Post



LEZHË- Arben Mhillaj, 41 vjeç, po lëvizte me një makinë të blinduar mbrëmjen e 26 gushtit në fshatin Torovicë, kur refuzoi urdhrin e efektivëve të policisë për të ndaluar. Patrulla e policisë i bëri me shenjë të ndalonte, por 41-vjeçari vijoi të lëvizte më shpejtësi dhe nuk ndali ndonëse policia iu vu nga pas. Disa minuta ka zgjatur ndjekja e Mhillajt, i cili u kap në fshatin Malecaj të Lezhës.

Brenda mjetit policia gjeti një armë zjarri me fishek në fole, e cila është sekuestruar bashkë me makinën e blinduar. Po ashtu, Mhillaj gjatë ndjekjes nga Policia hodhi edhe një krehër me fishekë.

Mhillaj nuk është një emër i panjohur për blutë. Ai rezulton me precedent penal për kanosje dhe kundërshtim të punonjësve të Policisë.

LEXO EDHE:
Hekurdha Vorë-Hani i Hotit, prezantohet projekti në Lezhë! Punimet do të përfundojnë brenda 2030-ës (VIDEO)

Ndërsa vëllai i tij **Florin Mhillaj**, bashkë me dy të tjerë janë shpallur në kërkim për **vrasjen e çiftit** Kreshnik e Gentjana Mujeci për gjakmarrje më 27 prill.

"Nga strukturat për hetimin e krimeve të DVP Lezhë, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja" dhe shërbimet e Komisarariatit të Policisë Lezhë, bazuar në informacionet e siguruara për një shtetas që qarkullonte i armatosur, u organizua dhe u finalizua operacioni i koduar "Unaza", në kuadër të të cilit u arrestua shtetasi:

-Arben Mhillaj, 41 vjeç, banues në fshatin Malecaj-Torovicë, Lezhë.

Ky shtetas u lokalizua në fshatin Torovicë, duke qarkulluar me një automjet të blinduar.

Shërbimet e Policisë i kanë bërë shenjë ndalimi, por drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit dhe ka vijuar lëvizjen me shpejtësi.

Pas disa minutash ndjekjeje, në fshatin Malecaj, u bë e mundur kapja dhe vënja në pranga e 41-vjeçarit.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar automjeti i blinduar, 1 armë zjarri pistoletë, me fishek në fole, dhe krehri i saj me disa fishekë, të cilat drejtuesi i automjetit i hodhi në tokë gjatë ndjekjes nga Policia", njofton Policia.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Florin Mhillaj Arben Mhillaj Lezhe

Sa e vlerësoni këtë artikull? ⭐⭐⭐⭐⭐ 3.0 / 5 (2 vlerësime)

🌟 LAJMET MË TË VLERËSUARA ➤

Komente

Komento

Turi:

I marin blindin qe ta vrase hasmi,kaq e thjesht eshte. Tani na 1 moralist qe do na jap mend,qe ku vete me pistolet me vete e keto broçkulla qe duhet ti din kontkstin ti thon. Jan ne gjak dhe shteti ka bere sehir,qekur i vran baban e tani qe vran keta shteti ri kot,dhe tani kaq blinden si trofe. Blinda e ruan shteti e vret

27/08/2026 14:16


🔒 Ndalohe

Sondazhi i ditës:
Si ju duket plani i qeverisjes i paraqitur në Pogradec nga Rama?

24 Gusht, 21:21

Mirë Keq Nuk e di


Lajme të tjera



'Rana e Hedhun' në Shëngjin 'magnet' për të huajt, turistët: Vijmë çdo vit, na pëlqen mikëpritja e banorëve!

Elvis Hila


25 Gusht, 17:23



Radhë kilometrike në Rugën e Kombit, trafiku rëndohet pranë Rrëshenit (VIDEO)

Elvis Hila

25 Gusht, 11:00



Ishte duke u larë në det, mbytet 19-vjeçari nga Kosova në Shëngjin

24 Gusht, 15:33




Kërcënoi me pistoletë 50-vjeçari me dy djemtë, arrestohet i riu në Kurbin (EMRI)

24 Gusht, 11:56



Përmirësohet situata me zjarret! 6 vatra mbeten aktive, në Malin e Dajtit vijon ndërhyrja! Bilanci i 2026-ës: 9050 hektarë pyje të shkumbuar

24 Gusht, 11:12



Mirditë/ Plas tubi gjatë furnizimit me ujë të zjarrfikëses, plagoset ushtari i Forcave të Armatosura (EMRI)


22 Gusht, 16:39



Në Shëngjin jo vetëm det! Mbahet Panairi i Librit, Zogaj për sfidën e Inteligjencës Artificiale: Jemi të vetmit që mund ta ruajmë gjuhën

Elvis Hila

22 Gusht, 13:06



Mirditë/ U kap duke ndezur Rraja në fshatin Rrëshen dhe Valës, arrestohet piromani 62-vjeçar (EMRI+VIDEO)

22 Gusht, 10:49



Zjarret, 4 vatra aktive/ Plagoset gjatë operacionit ushtari në Mirditë, dërgohet te 'Trauma'! Përmirësohet situata në Gojan të Pukës, rikthehen banorët e evakuuar! (VIDEO)

22 Gusht, 09:24



Ministri Nufi nga Mirdita: Zjarre agresive në fshatin Tenë, efektivët kanë rrezikuar edhe jetët! Problematike edhe vatrat në Dukat të Vlorës dhe Gojan të Pukës

21 Gusht, 18:58



Zjarret në Tenë dhe Kodër Rrëshen të Mirditës shkumbojnë gjithçka, Report Tv siguron pamjet (VIDEO)

21 Gusht, 18:33



Zjarret në Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes bën bilancin: 8 vatra kritike, situata më kritike në Pukë dhe Mirditë! 4 banesa të djegura në fshatin Gojan i Madh

21 Gusht, 18:12

Lajmi i fundit

Arrestohet në Londër 35-vjeçari i kërkuar nga SPAK për dosjen e Jan Prengës, nis procesi i ekstradimit drejt Shqipërisë

27 Gusht, 18:54 nga Sokol Dema



